



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJI DHE TRASHËGIMI KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi: Arkeologji dhe trashëgimi kulturore

TITULLI I LËNDËS: QYTETET NË EUROPËN JUGLINDORE SHEK.XIX-XX

Pedagogu: Dr. Gentiana Kera
Ngarkesa: 4 ETCS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: Lende me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: III/II

EKSTRAKT

Qëllimi i këtij cikli leksionesh është që të pasqyrojë zhvillimin e qytetit në Ballkan gjatë shekujve XIX-XX nga një perspektivë antropologjiko-historike. Tendencat e evropianizimit dhe modernizimit kanë qenë karakteristikë për vendet e Ballkanit gjatë shekujve XIX-XX, tendenca të cilat mes të tjerash u shprehën edhe në përpjekjet për t'u shkëputur nga trashëgimia osmane dhe modernizimin e strukturës së qyteteve, dhe sidomos të kryeqyteteve. Leksionet do të trajtojnë gjithashtu edhe zhvillimin e qyteteve gjatë periudhës socialiste në aspektin e planifikimit urban të qyteteve në periudhën e socializmit dhe të zhvillimit ekonomik dhe demografik të tyre.

Temat

LEKSION 1. Hyrje në Antropologjinë Historike, qyteti si objekt studimi i saj dhe specifika të studimit antropologjik të qytetit, burimet dhe metodat e antropologjisë historike.

LEKSION 2. “Qyteti osman” në Ballkan dhe karakteristikat e tij kryesore.

LEKSION 3. Trashëgimia osmane në strukturën e qytetit ballkanik dhe jetën qytetare. Organizimi hapësinor i qytetit.

LEKSION 4. Proceset e evropianizimit dhe modernizimit dhe ecuria e tyre në shtetet ballkanike.

LEKSION 5. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Turqi në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 6. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Bullgari në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 7. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Greqi në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 8. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Serbi në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 9. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Maqedoni në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 10. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në Shqiperi në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX

LEKSION 11. Transformimet urbane dhe zhvillimet demografike në qytetin e Tiranës në gjysmën e dytë të shek.XIX- gjysma e parë e shek.XX.

LEKSION 12. Qyteti socialist në Europën Juglindore. Urbanizimi dhe industrializimi në vendet e Bllokut Lindor.

LEKSION 13. Zhvillimet kryesore demografike dhe ekonomike gjatë periudhës socialiste.

LEKSION 14.. Migracioni. Politikat shtetërore për lëvizjet e popullsisë në vendet socialiste.

LEKSION 15. Familja socialiste. Ideologjia e familjes socialiste, modernizimi dhe tradita, martesat.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI: 70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

Literatura

Bushati, Vera and Isuf Sukaj, (1985) *Disa tipare mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qyteteve kryesore shqiptare gjatë viteve 1912-1944. Monumentet* 1 (29), fq. 95-100.

Duka Ferit (2002) Profili i një qyteti shqiptar të kohës osmane. Gjirokastra gjatë shekujve XV-XVI tek *Studime Historike* nr.1-2.

Duka, Valentina (1997) Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924.

Frashëri, Kristo (2004) Historia e Tiranës vëll. I

Kera, Gentiana/ Enriketa Papa (2008). Shkodra ose Tirana? Në kërkim të kryeqytetit të Shqipërisë së pavarur, tek Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX, Tiranë, fq. 285-299.

Kera, Gentiana (2007). “Europianizimi” i një kryeqyteti. Tirana në periudhën midis dy Luftërave Botërore. *Hylli i dritës*, 2, fq. 132-147.

Kera, Gentiana (2004). Qyteti i Tiranës në këndvështrimin e udhëtarëve të huaj, *Politika & Shoqëria*, Vol. 7, Nr. 1(13), fq. 69-77.

Miho, Koço (1987) Trajta të profilit urbanistik të qytetit të Tiranës

Riza, Emin (1977) Vështrim mbi urbanistikën e qytetit shqiptar shek.XII-XX, tek *Monumentet* nr.14.

Thomo, P. Korça-urbanistika dhe arkitektura, Tirana, 1988

Yerolympos, Alexandra (1996) Urban transformations in the Balkans (1820-1920). Aspects of Balkan town and the remaking of Thessaloniki

Weber, Max (2008) Qyteti